REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
NR. 975/19
Date/Datum 15.01.20
PRISHTINË PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit:* **10.01.2020**	*Data e dorëzimit të raportit:* **15.01.2020**	Nr. i lëndës: **975/19**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **30.12.2019**, grupi i OE: **"AM Group" Shpk.; "AAB Construction" Shpk; "Mirusha Company" Shpk; NNSH "Ardi" - Suharekë,** ka parashtruar ankesë me nr.:**975/19**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin e AK, (njoftimit për dhënie të kontratës)**, ku është rekomanduar për kontratë grupin e OE: **N.N.T. Etniku; KAG - Asphalt Company SH.P.K. - Suharekë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Asfaltimi i rruges që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi)-Lagjja Zekolli), Suharekë"**, me nr. të prokurimit: **624-19-6384-5-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna Suharekë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë e hapur**, lloji i kontratës: **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **700,000.00 €**

Shënim: Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr **një (1)** vendim nga OSHP-ja. *Vendimi me Nr. **766/19**, me datë **03.12.2019**.*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "AM Group" Shpk.; "AAB Construction" Shpk; "Mirusha Company" Shpk; NNSH "Ardi" - Suharekë

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 7 Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminim
Neni 56 – Dispozitat e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 66 – Përshtatshmëria Profesionale
Neni 72 – Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë
Neni 108/A – Zgjedha Preliminare e mosmarrëveshjeve

Përmes platformës elektronike te KRPP-se njoftohemi mbi Vendimin e autoritetit kontraktues me dt. 11.10.2019, se për këtë aktivitet te prokurimit me titull: Asfaltimi i rrugës qe lidhe fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi – Lagjia Zekolli) Suharekë, me numër te prokurimit: 624-19-6384-5-1-1, eshte shpallur fitues me çmimin e ofruar ne vlere prej 479,256.94 si ofertues me çmimin me te lire te ofruar grupi i operatoreve ekonomik NNT VEHA; "Euro Group" Shpk. Ne, në te njëjtën ditë jemi njoftuar nga AK me Letër standarde për tenderuesit e pasuksesshëm ngase çmimi i ofruar nga NE nuk ishte çmimi me i lire siç është kërkuar nga DT.

Po përmes platformës elektronike te KRPP-se njoftohemi mbi vendimin tjetër te autoritetit kontraktues me dt. 11.10.2019 mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit ngase ka pasur ankesë nga një OE.

Me dt. 12.12.2019 po përmes platformës elektronike njoftohemi mbi vendimin e Ri-vlerësimit te aktivitetit te prokurimit dhe shpalljes fitues te OE NNT Etniku; KAG – Asphalt Company Shpk, me çmimin te ofruar prej 628,713.80 euro, dhe ne te njëjtën dite njoftohemi me letër standarde për tenderuesin e eliminuar me Arsyetimin: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye – Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale / Ju mungojnë dëshmia për projekte te ngjashme siç është kërkuar, kontrata dhe referenca si dhe ju mungojnë dëshmitë për staf profesional siç është kërkuar me FDT.

Ju njoftojmë se me procesin e Rivlerësimit AK ka bere shkelje te LPP-se te të gjitha neneve te cekura me larte ku është shpallur fitues OE me çmimin me te shtrenjte te ofruar ngase Ne kemi kontrolluar edhe njëherë te gjitha dokumentet e dorëzuara dhe neve na rezulton se ne i plotësojmë te gjitha kriteret e kërkuara ne DT.

Kërkojmë nga Ju bëni anulimin e njoftimit mbi vendimin e AK te datës 12.12.2019 dhe letrës standarde te dt. 12.12.2019 dhe Ne te shpallemi fitues me çmimin me te ulet nga operatoret e përgjegjshëm për tenderin ne fjalë.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta me kërkesën për rishqyrtim pran autoritetit kontraktues.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëmkërkesa/kriteret qëkanëtëbëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesaqë lidhen me pretendimet ankimore).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kapaciteti teknik dhe profesional: ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	Evidencat:
Kërkesa1- Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme, ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 1.000.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve. **Kërkesa2 -Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushen perkatese, se paku 2.1.Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi Infrastrukture rrugore ose master drejtimi Infrastrukture rrugore, me se paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit. 2.2.Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktive ose master drejtimi drejtimi konstruktive, me se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe te jete i certifikuar me IWS ose ekuvalente. 2.3.Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i gjodezisë me pesë vite përvojë pune pas diplomimit dhe te jete i Licensuar si gjeodet.**	**Dëshmia1 -Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, DHE dëshmitë e përfundimit Referenca t ose procesverbali et e pranimit teknik.** **Dëshmia2 - Kontratat e punës ose mareveshjet me inxhinierin at, Diploma e NOTERIZUAR dhe nga një CV. Per stafin qe eshte kerkuar te jete i Licensuar te ofrohet edhe licensa.**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhetvetëmvlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni pasi vlersoi ofertat dhe duke u bazuarne vendimin e OSHP nr.766/19 rekomandon ZP qe fitues te shpallet Grupi i OE NNT ETNIKU & KAG ASPHALT shpk, me cmimin me te lire prej: 628.713,80 euro

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "AM Group" Shpk.; "AAB Construction" Shpk; "Mirusha Company" Shpk; NNSH "Ardi" - Suharekë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues, nuk ka respektuar nenin 7, 56, 59, 60, 66, 72 dhe 108/A të LPP-së, dhe jemi njoftohemi me letër standarde për tenderuesin e eliminuar me Arsyetimin: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye – Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale / Ju mungojnë dëshmia për projekte te ngjashme siç është kërkuar, kontrata dhe referenca si dhe ju mungojnë dëshmitë për staf profesional siç është kërkuar me FDT. Andaj, me procesin e Rivlerësimit AK ka bere shkelje te LPP-se te të gjitha neneve te cekura me lartë ku është shpallur fitues OE me çmimin më të shtrenjtë te ofruar ngase, Ne kemi kontrolluar edhe njëherë te gjitha dokumentet e dorëzuara dhe neve na rezulton se ne i plotësojmë të gjitha kriteret e kërkuara ne DT.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, OE ankues tek deklarata detale mbi faktet dhe argumentet nuk ka sqaruar se cilat janë ato kontrata te prezantuar ne listën e kontratave dhe stafit qe e plotësojnë kërkesën e autoritetit kontraktues (duke përshkruar ne mënyrë te detajuar), por vetëm thotë, po citoj: "*Ne kemi kontrolluar edhe një here te gjitha dokumentet e dorëzuara dhe neve na rezulton se ne i plotësojmë te gjitha kriteret e kërkuara ne DT*". Andaj duke pasur se këto pretendime ankimore janë trajtuar/shqyrtuar me parë ne **vendimin e OSHP-së me Nr. 766/19**, te datës 03.12.2019 dhe konsideroj si çështje te gjykuara **"Res Judikata"**, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e grupit të OE ankues ***<u>të refuzohet e pa bazuar</u>***, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Komuna Suharekë*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *Grupi i OE ankues – "AM Group" Sh.p.k.; "AAB Construction" Sh.p.k.; "Mirusha Company" Sh.p.k.; NNSH "Ardi" - Suharekë*

S.B